

Albanian

FORMULAR ANKESE

Udhëzime të përgjithshme

Kush mund të paraqesë ankesë?

1. Ju ose një person apo palë që vepron në emrin tuaj, mund të paraqisni një ankesë pranë Agjencisë Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, Frontex¹, nëse besoni se jeni prekur drejtpërdrejt nga veprimet apo mosveprimet e personelit të përfshirë në një aktivitet të Frontex¹, dhe ju mendoni se ju janë shkelur një ose më shumë të drejta themelore për shkak të atyre veprimeve ose mosveprimeve. Për një listë të "Shkeljeve të të drejtave themelore të mundshme gjatë operacioneve" shikoni seksionin "Informacion shtesë" të mekanizmit të ankesave në uebsajtin e Agjencisë.
2. Ju mund të përfaqësoheni nga çfarëdo palë (p.sh. një person tjetër, avokat, organizata, anëtar i familjes, kujdestar ligjor etj.). Secila prej këtyre palëve mund të depozitojë një ankesë në emrin tuaj.
3. Në rastin e shkeljeve të dyshuara të rregullave rreth përdorimit të forcës² nga personeli i Frontex i dislokuar si anëtarë të ekipit, çdo person mund t'i raportojë shkeljet e pretenduara.
4. Mund të paraqiten edhe çështje që përfshijnë disa ankues.

Si mund të paraqesë ankesë?

5. Ankesa juaj duhet të paraqitet **me shkrim**. Ankesa juaj do të përpunohet nga Oficeri i Frontex për të Drejtat Themelore (FRO), një ekspert i pavarur që monitoron dhe promovon të drejtat themelore brenda Frontex. Përdorimi i këtij formulari ankesë do të ndihmojë FRO-në që ta përpunojë ankesën tuaj në mënyrë më efikase, por ju mund të paraqisni ankesë edhe përmes formave të tjera me shkrim, sipas zgjedhjes suaj. Në çdo fazë të procedurës, FRO-ja mund t'ju kërkojë të paraqisni informacion, dokumentacion ose qartësim shtesë për ankesën tuaj. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të shtoni të dhënat tuaja të kontaktit.
6. Ankesat mund të paraqiten në çdo gjuhë. Formularët e ankesave disponohen në disa gjuhë.
7. Nuk ka një gjatësi maksimale për ankesën tuaj, por preferohet që të gjitha informacionet të përmbliidhet në **jo më shumë se 15 faqe**.
8. Ankesën tuaj duhet ta paraqisni brenda një viti nga data kur ndodhi shkelja e pretenduar e të drejtave tuaja themelore ose kur u informuat ose mësuar rreth saj apo ndryshe kur ishit në gjendje të paraqisnit ankesën.

¹ Aktiviteti i Frontex nënkupton një: operacion të përbashkët, projekt pilot, ndërhyrje të shpejtë kufitare, dislokimi i ekipit mbështetës të menaxhimit të emigracionit, operacion kthimi, ndërhyrje kthimi ose një aktivitetet operacionale të Agjencisë në një vend të tretë. Për përkufizimet e këtyre aktivitetëve, ju lutemi referojuni Rregullores (BE) 2019/1896 të datës 13 nëntor 2019, mbi Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare. (OJ L 295, 14.11.2019, fq. 1).

² Ju lutemi referojuni Rregullores 2019/1896, Aneksi V mbi rregullat mbi përdorimin e forcës, duke përfshirë trajnimin dhe furnizimin, kontrollin dhe përdorimin e armëve të shërbimit dhe pajisjeve jovdekjeprurëse, që aplikohen për personelin e Frontex të dislokuar si anëtarë të ekipeve.

9. Ankesa juaj mund t'u referohet vetëm fakteve që kanë ndodhur ose efektet e të cilave kanë vazhduar pas datës 6 tetor 2016³, ndryshe ajo do të jetë e papranueshme.
10. Nuk është nevoja që të kaloni procedurat kombëtare përpara se të paraqisni ankesën tuaj.
11. Nëse paraqisni ankesë pranë Frontex, kjo nuk ju pengon të keni akses në forma të tjera ankese, siç janë gjykatat kombëtare ose evropiane.
12. Ju duhet të shpjegoni sa më shumë që të jetë e mundur **faktet e detajuara** të ankesave tuaja, **duke identifikuar ndikimin** që ato veprime ose mosveprime kishin në të drejtat tuaja themelore.
13. Depozitimi i një ankese është **falas**.

Çfarë ndodh pasi paraqes ankesën time?

14. Frontex dhe FRO-ja do t'i trajtojnë të gjitha ankesat si **konfidenciale** përveçse kur ju shprehimisht hiqni dorë nga e drejta juaj për konfidencialitet në këtë formular ose në ndonjë mënyrë tjetër me shkrim.
15. Nëse ankesa juaj u referohet veprimeve ose mosveprimeve të kryera nga një anëtar i ekipeve nga një Shtet Anëtar pjesëmarrës i dislokuar në një aktivitet të Frontex, ankesa juaj do të referohet nga FRO-ja tek autoritetet kombëtare që trajtojnë ankesat individuale dhe tek institucionet kombëtare për të drejtat themelore. FRO-ja do t'ju informojë se cilat autoritete e kanë marrë ankesën tuaj. Ju duhet të jepni shprehimisht miratimin tuaj që FRO-ja t'ua kalojë të dhënat tuaja personale autoriteteve përkatëse (shikoni Seksionin 5 në formularin e ankesave).
16. Nëse ankesa juaj deklarohet e papranueshme, FRO-ja do t'ju informojë me shkrim rreth arsyeve për papranueshmërinë dhe, nëse është e mundur, do t'ju japë opsione të mëtejshme për t'iu përgjigjur shqetësimeve tuaja.
17. Çdo ndryshim adrese, emaili apo të dhënash të tjera kontakti të ankuesit, duhet t'i njoftohen FRO-së sa më shpejt të jetë e mundur.

Informacione shtesë mbi mekanizmin e ankesave të Frontex mund të gjenden në uebsajtin e Agjencisë: www.frontex.europa.eu/complaints

1. Informacion rreth ankuesit/ankuesve

*Këtë kërkesë ju po e paraqisni si:
(zgjdhni atë që është e përshtatshme)*

Personi/personat e prekur direkt

Pala që përfaqëson personin/personat e prekur

Çdo person që dyshohet për shkelje të rregullave të përdorimit të forcës nga personeli i Frontex i dislokuar si anëtar i ekipeve

Ju lutemi jepni të paktën një të dhënë kontakti nga ankuesi ose përfaqësuesi.

Përfaqësuesi:

³ Data e hyrjes në fuqi e Rregullores (BE) 2016/1624 mbi Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare.

ANKUESI/ANKUESIT:

Mbiemri/Mbiemrat:

Emri/Emrat:

Mosha mbi 18 vjeç: Po Jo

Nënshtetësia/Nënshtetësitë (nëse dihet):

Nëse nuk ka nënshtetësi, ju lutemi specifikoni vendin e fundit të banimit:

Adresa për korrespondencën:

Kodi postar:

Qyteti:

Shteti:

Emaili:

Tel. (jepni prefiksin e shtetit dhe të zonës):

Faks:

Informacione të tjera të rëndësishme:

Për çështjet që përfshijnë më shumë se një ankues, ju lutemi shtoni të dhënat personale për secilin individ.

PËRFAQËSUESI I ÇDO PALE:

Mbiemri/Mbiemrat:

Emri/Emrat:

Lidhja me ankuesin:

Emri i organizatës, aty ku aplikohet:

Adresa për korrespondencën:

Kodi postar:

Qyteti:

Shteti:

Emaili:

Tel. (jepni prefiksin e shtetit dhe të zonës):

Faks:

Informacione të tjera të rëndësishme:

Shënim: Ankuesi duhet të nënshkruajë në fund të formularit të ankesës për të treguar miratimin e vet për këtë përfaqësim. Nëse ankuesi nuk është në gjendje të nënshkruajë formularin e ankesës për arsye të justifikuar (p.sh. ka vdekur, është zhdukur, i burgosur pa të drejtë komunikimi, arsye shëndetësore, është analfabet) ose ka arsye të tjera të forta që ankuesi të mos japë një autorizim me shkrim për përfaqësimin tuaj, ju lutemi shpjegoni arsyet:

2. Informacion rreth shkeljeve të pretenduara të të drejtave themelore ose rregullave të përdorimit të forcës

Ju lutemi jepni informacion mbi shkeljet e pretenduara të të drejtave themelore ose rregullat e përdorimit të forcës duke përfshirë datat, vendet, një përshkrim të veprimeve ose mosveprimeve dhe personelin e përfshirë. Ju lutemi shpjegoni pse besoni se këto veprime ndikuan te të drejtat tuaja themelore ose ato të personit/personave të cilët ju përfaqësoni:

- a) Data dhe ora e përafërt e ngjarjes/ngjarjeve:
- b) Vendndodhja/shteti:

Në rast se vendndodhja e saktë është e panjohur, ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar të vendit ku ndodhi ngjarja:

- c) Përshkrim i detajuar i personit/personave kundër të cilëve ankoheni. Përshkruani, sipas njohurive tuaja më të mira, nëse ankuesi u referohet veprimeve ose mosveprimeve për të vepruar të kryera nga (shënoni të gjitha që aplikohen):
 - I. Person/persona që mbanin uniforma blu të Frontex, e identifikueshme nga një shirit në kraharor me ngjyrë të kaltër
 - II. Person/persona me shirit në krahu të Frontex me ngjyrë blu të çelur
 - III. Person/persona me karta identifikimi të Frontex
 - IV. Person/persona që mbanin uniforma kombëtare të vendit ku ndodhi aktiviteti
 - V. Persona të tjerë, si përkthyes, shoferë etj.

Jepni informacion rreth personit/perosnave të përfshirë (p.sh. emri, përshkrimi i veshjes, gjuha e folur, pamja fizike, çfarë pune ose funksionesh bënte ai/ajo etj.):

d) Përshkrim i detajuar i ngjarjes, nëse është e mundur në rend kronologjik. Nëse shkelja e pretenduar vazhdon ende, ju lutemi specifikojeni:

e) Nëse ankesa lidhet me shkelje të pretenduara të të drejtave themelore, ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar rreth mënyrës se si ngjarja e përshkruar më lart ka ndikuar te ju dhe se si ju mendoni se ajo shkel të drejtat tuaja themelore (për një listë të "*Shkeljeve të të drejtave themelore të mundshme gjatë operacioneve*" shikoni seksionin "*Informacion shtesë*" të mekanizmit të ankesave në uebsajtin e Agjencisë):

3. Paraqitja i ankesës suaj tek autoritetet e tjera

Shënim: Nuk është nevoja që ju të kryeni procedura kombëtare të ndonjë lloji përpara paraqitjes së ankesës suaj pranë Frontex.

1) A e keni paraqitur tashmë ankesën tuaj pranë ndonjë gjykate (p.sh. kombëtare, evropiane etj.)? Ju lutemi specifikoni cilën gjykatë, statusin aktual dhe rezultatin e procedurës, nëse dihet:

2) A e keni paraqitur ankesën tuaj pranë ndonjë institucioni tjetër (p.sh. avokati i popullit, ndonjë institucion kombëtar i të drejtave të njeriut etj.)? Ju lutemi specifikoni se në cilin institucion, statusin aktual dhe rezultatin e procedurës, nëse dihet:

4. Kopje të dokumenteve mbështetëse

1) Ju lutemi jepni **kopje** të të gjitha dokumenteve mbështetëse të disponueshme që lidhen me ankesën tuaj. **Shembuj** të këtyre dokumenteve mund të jenë:

- kopje e kartës së identitetit, pasaportës apo ndonjë forme tjetër identifikimi;
- kopje të çdo dokumentacioni, të fotografive, videove, raporteve, certifikatave, deklaratave të dëshmitarëve ose dokumente të tjera mbështetëse që lidhen me ankesën tuaj;
- nëse e keni paraqitur ankesën tuaj pranë gjykatave ose institucioneve të tjera, kopje të formularëve të ankesave, deklarimeve ose vendimeve që lidhen me këto procedura.

2) Nëse nuk mund të jepni dokumentacione mbështetëse, ju lutemi shpjegoni:

Shënim: Ju lutemi mos dërgoni origjinalet sepse ato nuk do t'ju kthehen

5. Konfidencialiteti dhe të dhënat personale

Duke dërguar këtë ankesë, ju pajtoheni me përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Oficeri i të Drejtave Themelore (FRO). Ju lutemi gjeni informacione të mëtejshme rreth përpunimit të të dhënave tuaja në deklaratën e mëposhtme të privatësisë.

FRO-ja i trajton ankesat në mënyrë konfidenciale. Nëse ankesa juaj deklarohet si e pranueshme, ajo do t'u referohet për ndjekje autoriteteve kompetente (Drejtori Ekzekutiv i Frontex dhe autoritetet kombëtare nga Shtetet Anëtare përkatëse) dhe u dërgohet institucioneve përkatëse kombëtare të të drejtave themelore.

Ju lutemi konfirmoni se autorizoni shprehimisht FRO-në të zbulojë të dhënat tuaja tek autoritetet kompetente dhe institucionet e të drejtave themelore. Nëse vendosni që të mos i ndani të dhënat tuaja, ankesa juaj mund të refuzohet nga ato autoritete.

Përmes kësaj unë miratoj dërgimin e të dhënave të mia personale te Drejtori Ekzekutiv i Frontex, autoritetet kombëtare nga Shtetet Anëtare përkatëse dhe institucionet përkatëse kombëtare të të drejtave themelore, aty ku aplikohet (ju lutemi shënoni):

PO

JO

6. Zgjidhja ligjore

Nëse ankesa juaj provohet, çfarë mendoni se mund të bëjnë Frontex ose institucionet e tjera për t'iu përgjigjur dëmit të shkaktuar?

7. Paraqitja e ankesës suaj

Ju mund ta paraqisni ankesën tuaj dhe bashkëngjitjet e nevojshme përmes këtyre rrugëve:

- Emaili: complaints@frontex.europa.eu
- Uebsajti i Frontex: www.frontex.europa.eu/complaints
- Direkt te personeli i Frontex ku zhvillohet aktiviteti.
- Postë: Frontex - Fundamental Rights Officer, Complaints
Plac Europejski 6
00-844 Warsaw
Poland

Në rast paraqitjeje të këtij formulari elektronik, ju lutemi shkruani emrin tuaj të plotë më poshtë:

Data: _____ Ankuesi: _____

Data: _____ Përfaqësuesi i palës: _____

Mekanizmi i Frontex për ankesat DEKLARATA E PRIVATËSISË

1. ÇFARË TË DHËNASH PERSONALE GRUMBULLOJMË NE?

Të dhënat personale që ju jepni përmes ankesës suaj, duke përfshirë emrin tuaj, të dhënat e kontaktit ose dokumentet mbështetëse (si p.sh. raportet mjekësore ose policore ose fotografitë).

2. PSE I GRUMBULLOJMË NE TË DHËNAT TUAJA?

Të dhënat tuaja do të përpunohen në mënyrë që Oficeri i të Drejtave Themelore (FRO) dhe personeli i Zyrës së të Drejtave Themelore, që do të trajtojnë ankesën tuaj, të mund ta përpunojnë ankesën.

3. BAZA LIGJORE PËR PËRPUNIMIN

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja është Neni 111, paragrafi 11 i Rregullores (BE) 2019/1896. FRO-ja do t'i përpunojë të dhënat tuaja bazuar në Nenin 5, paragrafi 1 (d) i Rregullores (BE) 2018/1725⁴. Duke paraqitur ankesën tuaj, ju jepni miratimin tuaj për përpunimin. Ju keni të drejtën ta anuloni atë miratim në çdo kohë.

4. KUSH I GRUMBULLON TË DHËNAT TUAJA?

Të dhënat tuaja do të grumbullohen nga FRO-ja, që është kontrolluesi i të dhënave. Ju mund të kontaktoni me FRO-në në adresën complaints@frontex.europa.eu.

5. KUSH TJETËR MUND T'I SHOHË TË DHËNAT TUAJA?

Vetëm nëse jepni miratimin, FRO-ja dhe personeli i Zyrës së të Drejtave Themelore, të cilët do të trajtojnë ankesën tuaj, mund t'i dërgojë të dhënat tuaja te: Drejtori Ekzekutiv i Frontex, autoritetet kombëtare kompetente nga Shtetet Anëtare përkatëse dhe institucionet përkatëse kombëtare të të drejtave themelore; zbulimi i të dhënave tuaja te këto palë do të varet nga personi që pretendohet se ka shkelur të drejtat tuaja dhe nga të drejtat që pretendohet se janë shkelur.

Nëse nuk jepni miratim, të dhënat tuaja nuk do të zbulohen. Është e rëndësishme që ju të dini se pa miratimin tuaj ankesa juaj mund të refuzohet nga ato autoritete, në rast se ato nuk pranojnë ankesa anonime.

Të dhënat tuaja nuk do t'i jepen një vendi të tretë ose një organizate ndërkombëtare.

⁴ Rregullorja (BE) 2018/1725 e datës 23 tetor 2018, mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. (OJ L 295, 21.11.2018, fq. 39–98).

6. PËR SA KOHË I MBAJMË NE TË DHËNAT TUAJA?

Të dhënat tuaja do të ruhen për një periudhë tre (3) vjeçare. Nëse ia keni paraqitur të njëjtën ankesë gjykatave kombëtare ose ndërkombëtare, të dhënat tuaja do të ruhen për një periudhë pesë (5) vjeçare, për shkak të procedimeve gjyqësore. Periudha e ruajtjes llogaritet nga momenti i zbulimit të çështjes. Pas asaj periudhe, të dhënat do të fshihen.

7. CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?

Ju keni të drejtën e aksesit në të dhënat tuaja dhe të drejtën t'i kërkonit FRO-së të korrigojë ose fshijë të dhënat tuaja ose të kufizojë përpunimin e tyre. Ju mund të paraqisni një ankesë pranë Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave në www.edps.europa.eu. Në rast se ju nevojitet ndonjë qartësim, ju mund të kontaktoni gjithashtu me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave të Frontex në adresën dataprotectionoffice@frontex.europa.eu. Nuk do të ketë vendimmarrje automatike bazuar në të dhënat tuaja.

8. PERSONAT E TJERË TË PËRMENDUR NË ANKESËN TUAJ

Nëse në ankesën tuaj ju na jepni të dhënat e ndonjë dëshmitari, personat që pretendohet se kanë shkelur të drejtat tuaja ose të personave të tjerë, FRO-ja dhe personeli i Zyrës së të Drejtave Themelore, që do të trajtojnë ankesën tuaj, do t'i përpunojnë edhe këto të dhëna. Këta persona do të informohen rreth përpunimit të të dhënave të tyre aty ku është e mundur.